


Themelet, përkatësisht bazamenti i një objekti të arkitekturës u zbuluan rreth 20 m ne jugperëndim të çezmës. Ngriheshin nga blloqe të mëdha gurësh te gdhendur të mermerit, gurëve gëlqerorë etj. të formësuar në trajtë shkallaresh. Baza e këtij bazamenti ka këto dimensione: 2.80 x 2.80 m me lartesi 1m. Bazamenti i ka takuar një objekti të arkitekturës qytetare të Prishtinës dhe ne fazën e gjurmimeve të tashme është vështirë të datohet me saktësi. Datimin e tij e vështirëson gjymtimi i objektit sikurse edhe shkatërrimi i shtresave kulturore gjatë ndërtimeve të viteve 50 – ta te shekullit XX.

Jemi të mendimit që *çezma* te konservohet dhe mundesisht te ruhet *in situ* (ne vendin e zbulimit) me mundesi zhvendosje qe e percakton nje grup ekspertesh, deri sa struktura e bazamentit te konservohet dhe te mbetet (te mbulohet) ne vendin e gjetjes.


Vendimin-fjalën perfundimtare vleresojme ta percaktoj Komisioni per Trashegimi Kulturore i MKRS-se.

Dr. Enver Rexha



IAK

Haxhi Mehmetaj



IMMRP